

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 01.12.2023 i është drejtuar Gjykatës me kërkesën me objekt: Caktimin e masës së sigurimit shtrëngues “*Arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale ndaj personave nën hetim **L. K., A. B. P. A, E.M, T.T, N.S, B. K, E. K, J.LI, K.Z, M.M**, si dhe caktimin masës së sigurimit shtrëngues “*Arrest në shtëpi*” parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale ndaj personave nën hetim **V. B, A.Th, S. K dhe S.T.**

2. Lidhur më shqyrtimin e kësaj kërkesë, Gjykata vendosi ta shqyrtoi në dhomë këshillimi pa praninë e palëve dhe të sekretares gjyqësore. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Irena Gjoka, bazuar në nenin 244 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 134 Akti, datë 07.12. 2023, ndër të tjera vendosi: Caktimin e masës së sigurimit shtrëngues “*Arrest me burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale ndaj personave nën hetim **L. K, A. B, E.M, T.T, N.S, B.K, J.LI, K.Z dhe M.M**, si dhe caktimin masës së sigurimit shtrëngues “*Arrest në shtëpi*” parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale ndaj personave nën hetim **P.A, . E.K, V. B, A.Th, S. K dhe S.T.**

3. Pasi është bërë ekzekutimi i masave të sigurimit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar bazuar në nenin 248 të K.Pr.Penale, paraqiti në Gjykatë kërkesën me objekt: Marrjen në pyetje të personave nën hetim.

4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Irena Gjoka, me vendimin Nr. 136 Akti, datë 11.12.2023, vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetasit nën hetim **L.K.**, i dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetasit nën hetim **A.B.**, i dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, dy herë, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

3. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetasit nën hetim **P.A.**, i dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

3.1. Urdhërohet shtetasi nën hetim **P.A.**, të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga “*****”, ndërtesa **, hyrja *, ap. *, njësia administrative *.

4. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në burg**” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetasit nën hetim **T.T.**, i dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

5. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në burg**” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetasit nën hetim **N.S.**, i dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

6. Zvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në burg**” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues “arrest në shtëpi” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale ndaj shtetasit nën hetim **J.Ll.**, i dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

6.1-Urdhërohet shtetasi nën hetim **J.Ll**, të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur në Tiranë, në adresën: Lagjia “*****”.

7. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në burg**” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetasit nën hetim **B. K.**, i dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

8. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në shtëpi**” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetasit nën hetim **E. K.**, e dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

8.1-Urdhërohet shtetasja nën hetim **E. K.**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: Bulevardi “*****”, ndërtesa **, hyrja *, njësia administrative nr. *.

9. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në shtëpi**” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, ndaj shtetases nën hetim **S. T.**, e dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

9.1-Urdhërohet shtetasja nën hetim **S. T.**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga “*****”, ndërtesa **, hyrja *, ap.*, njësia administrative nr. *.

10. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetases nën hetim **A. Th.**, e dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

10.1. Urdhërohet shtetasja nën hetim **A. Th.**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga “*****”, ndërtesa **, hyrja *, ap. **, njësia administrative nr. *.

11. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetases nën hetim **V. B.**, e dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

11.1. Urdhërohet shtetasja nën hetim **V. B.**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga “*****”, ndërtesa **, hyrja *, ap. **, njësia administrative nr.**.

12. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.134, datë 07.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj shtetases nën hetim **S. K.**, e dyshuar: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

12.1. Urdhërohet shtetasja nën hetim **S. K.**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga “*****”, ndërtesa **, hyrja *, ap. *, njësia administrative nr. *.

13-Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

14-Kundër këtij vendimi lejohet e drejta e ankimit nga palët, brenda pesë ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

U shpall në Tiranë, sot më datë 11.12.2023

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar